

KORRIGJIM GABIMI MATERIAL

Në vendimin nr. 72, datë 13.4.2022, “Mbi miratimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 2022–2024”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 58, datë 15.4.2022, përkatësisht në bazën ligjore, bëhen korrigjimet si më poshtë:

Paragrafi i fundit ndryshon, si më poshtë vijon:

“... Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.4.2022, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 486/1 prot., datë 11.4.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe e Çmimeve, “Mbi miratimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 2022–2024.”.

Paragrafi 2 bëhet:

“Procesi i shqyrtimit të aplikimit ka kaluar nëpërmjet rishikimit të vazhdueshëm të kërkesës për të ardhura nga OST sh.a., fillimisht me kërkesën drejtuar në ERE, me anë të shkresës nr. 5215 prot., datë 31.8.2021 dhe, më tej, përditësimin tij me anë të shkresave nr. 5215/1 prot., datë 5.10.2021, nr. 5215/3 prot., datë 4.11.2021 dhe nr. 6901/3 prot datë 23.12.2021.”.

Paragrafi 17 bëhet.

“Të ardhurat e kërkuara, që priten të realizohen nga OST sh.a., janë llogaritur për periudhën rregullatore 2022–2024 dhe tarifa e re të transmetimit të energjisë elektrike, e cila do t’i shtrijë efektet nga data 1 maj 2022, është përlogaritur duke konsideruar dhe diferencën e korrigjueshme të të ardhurave të kërkuara për periudhën janar–prill 2022, për efekt të rikuperimit të të ardhurave të pafaturuara në 4-mujorin e parë. Kjo diferencë nuk ndikon në tarifën mesatare të transmetimit për periudhën 2022–2024 dhe do të korrigjohet në zbritje të të ardhurave të kërkuara në vitin e dytë të periudhës rregullatore.”.

Paragrafi 18 bëhet:

“Tarifat e transmetimit të energjisë elektrike për çdo vit të periudhës rregullatore 1 maj 2022–31 dhjetor 2024, rezultojnë: a) 0.85 lekë/kwh për periudhën 1 maj 2022–31 dhjetor 2022; b) 0.89 lekë/kwh për vitin 2023; c) 0.83 lekë/kwh për vitin 2024.”.

Paragrafi 19 bëhet:

“Nga sa më sipër, tarifa e transmetimit për periudhën rregullatore 1 maj 2022–31 dhjetor 2024, rezulton 0.85 lekë/kwh.”.